



Planuar / Dateduar Propozuar/Propozuar Niveli/ndalimi	09.03.2022	2	viti god. vitet
Organ Njësia Organ /Njësia Org./Unit	Ab. Prost Bil. Prost Post. No.	Shënim Prilog Appendix	Seria Kategoria Quantity
SKRIPSHI	1262/2022		115



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.29/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.29/2022 të datës 14.01.2022 e parashtruar nga ankuesi me adresë banimi: kundër Vendimit numër: 1424/2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 17.12.2021, në çështjen juridike "Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 09.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. APROVOHET si e bazuar ankesa me numër A.nr.29/2022 e datës 14.01.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. SHFUQIZOHET Vendimi numër: 1424/2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 17.12.2021
- III. OBLIGOHET Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Punëve të Brendshme, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të tij, duke e kthyer ankuesin në vendin e tij të punës sipas ndryshimit dhe plotësimit të akt emërimit të datës 06.04.2016 me Nr.28/2016.
- IV. OBLIGOHET Njësia e Burimeve Njerëzore që ankuesit t'ia bëjë kompensimin pagës prej momentit të ndërprerjes së marrëdhënies së punës deri në momentin e zbatimit të këtij vendimi.
- V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

Arsyetim

Ndaj ankuesit, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, Zv/Sekretarja e Përgjithshme me datë 18.11.2021 ka iniciuar procedurën disiplinore pranë Komisionit Disiplinor me arsyetimin se i njëjti në cilësinë e UD/udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme e ka shqyrtuar kërkesën e Zv/Sekretares së Përgjithshme për inicim të procedurës disiplinore dhe me datë 17.12.2021 ka nxjerr vendimin me Nr.1424/2021 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil"

Ankuesi, i pakënaqur me Vendimin Nr.1424/2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme të datës 17.12.2021, me datë 14.01.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila është protokolluar me numër:167/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 25.01.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në anekse të Ministria e Punëve të Brendshme. Këshilli me datë 08.02.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Ministria e Punëve të Brendshme, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli me datë 22.02.2022 ka mbajtur seancë publike në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa për seancë institucioni- Ministria e Punëve të Brendshme ishte njoftuar sipas shkresës të datës 18.02.2022 me numër prot:860/2022 dërguar nëpërmjet e-maili me datë 18.02.2022 mirëpo nuk ka prezantuar askush pa dhanë asnjë shpjegim paraprak, ndërsa në seancë prezentë kanë qenë ankuesi si dhe katër (4) dëshmitarë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, në mungesë të provave të dërguara pjesërisht sipas kërkesës së parë të datës 25.01.2022 si dhe në mungesë të pjesëmarrjes në seancën publike të datës 22.02.2022, me datë 22.02.2022 i është drejtuar Menaxheres së Njesisë së Personelit të MPB-së me kërkesën për prova shtesë, të cilat me datë 23.02.2022 Menaxherja e Njesisë së Personelit i ka përcjellë përmes e-mailit të cilat janë protokolluar me numër:960/2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit të datës 14.01.2022 me numër protokoll 167/2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Shkresën e quajtur Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit të Brendshëm në përmbajtje prej 17 faqesh; Vendimi numër:1424/2021 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 17.12.2021; Provat dhe dëshmitë lidhur me shkeljen e pretenduar nr.1; Provat dhe dëshmitë lidhur me shkeljen e pretenduar nr.2; Provat dhe dëshmitë lidhur me shkeljen e pretenduar nr.3; Provat dhe dëshmitë lidhur me shkeljen e pretenduar nr.4; Provat dhe dëshmitë lidhur me shkeljen e pretenduar nr.5; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 25.01.2022; përgjigja në kërkesë e datës 08.02.2022 me numër protokoll 594/2022; E-mailin e datës 25.01.2022 dërguar nga Kryetari i këshillit për anëtarin e Kolegjit; E-mailin e datës 27.01.2022 dërguar nga Kryetari i Kolegjit për zyrtarin Z.G me shkresat e bashkangjitura; Raportin e Auditimit me kërkesë "Menaxhimi i kontratave publike të ndërtimit nga DSPIMNQ i datës 18.10.2022; Raportin e Auditimit të Njesisë së Auditorit të Brendshëm i përfunduar me datë 18.10.2021; (Ky raport bazuar në shkresat e lëndës dhe vet deklaratimet e ankuesit nuk i është dorëzuar asnjëherë për të analizuar

apo për tu përgjigjur ne konstatimet e pikave ne draft raport sipas standardeve) E-mailin e datës 17.07.2021 dërguar nga [] për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitura të e-maileve në përbërje prej 2 faqesh; E-mailin e datës 15.09.2021 dërguar nga [] për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; Raportin për projektin e ndërtimit të objektit të KPMS i datës 14.09.2021; Njoftimin e KRPP-së me numër 32/2020 të datës 10.09.2020; Rikërkesën për inicim të procedurave të prokurimit për punë shtesë për projektin: "Ndërtimi i ndërtesës së IKAP" e datës 16.07.2021; Kërkesën për inicim të procedurave të prokurimit për punë shtesë për projektin: "Ndërtimi i ndërtesës së IKAP" e datës 04.03.2021; Kërkesën për fillimin e proceduarve të prokurimit për projektin "Ndërtimi i Objektit të IKAP"-punët shtesë e datës 07.10.2020; Raporti i Komisionit të vlerësimit për ofertën e punëve shtesë të parapara për kontratën me titull: Lot 10 "Ndërtimi i Objektit të IKAP"-Prishtinë i datës 06.10.2020; Njoftimi për Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik i datës 13.01.2021; Raportin e vlerësimit të tenderëve i datës 04.11.2021; Raporti i Auditimit të Njesisë së Auditorit të Brendshëm i datës 03.08.2021; E-mailin e datës 22.06.2022 dërguar nga [] për ankuesi; Shkresën e ASHI të datës 21.06.2021 për kërkesën për fillim të procedurave të prokurimit për projektin "përkrahje për sistemin e menaxhimit të pasurisë për vitet 2021-2024; Deklaratën e nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve sipas nenit 9 të ligjit të Prokurimit publik Nr.04/042 të datës 21.06.2021; Kërkesën për prokurimin e projekteve e datës 21.06.2021; Shkresën e titulluar "Specifikimi teknik për projektin Përkrahje për sistemin e Menaxhimit të Pasurisë për vitet 2021-2024 e datës 16.06.2021; E-mailin e datës 15.07.2021 dërguar nga ankuesi për Drejtor i ASHI me korrespondencën e bashkangjitur prej 9 faqesh; Raportin e ekspertit shqyrtues i datës 15.07.2021; Njoftimi për kontratë i datës 02.07.2021; Kërkesën e datës 13.08.2020 për fillimin e procedurave të prokurimit për projektin "Ndërtimi i objektit të QTM Pejë faza1" i protokolluar me datë 21.08.2020; Ri-kërkesën e datës 21.07.2020 për fillimin e procedurave të prokurimit për projektin "Ndërtimi i objektit të QTM Pejë faza1" i protokolluar me datë 19.10.2021; Kërkesën për inicimin e procedurave te prokurimit për pune shtese për projektin "Ndërtimi i Qendrës për Vlerësim dhe Standarde-QVS" e datës 12.03.2021; E-mailin e datës 09.03.2021 dërguar nga [] për [] Kërkesën për inicimin e procedurave te prokurimit për pune shtese për projektin "Ndërtimi i Qendrës për Vlerësimin dhe Standarde-QVS Prishtinë-punë shtesë" e datës 27.11.20219; Raportin e Komisionit të vlerësimit për ofertën e punëve shtesë për kontratën me titull "Ndërtimi i ndërtesave Qeveritare dh Institucioneve Arsimore-lot 2-Qendra për Vlerësim dhe Standarde"-Prishtinë të datës 26.11.2019; Kërkesën për Filli të Procedurave të Prokurimit për Projektin "Ndërtimi i Objektit të QTM-Pejë-faza 1" -punë shtesë të datës 13.08.2020; Ri-kërkesën për Inicim të Procedurave të Prokurimit për punë shtesë për projektin: "ndërtimi i Qendrës për Vlerësim dhe standarde-QVS" të datës 16.07.2021 i protokolluar me datë 19.10.2021; Kërkesën për Inicimin të Procedurave të prokurimit për punë shtesë për projektin "Ndërtimi i Ndërtesës së IKAP" të datës 09.03.2021; Raportin e Komisionit të vlerësimit për ofertën e punëve shtesë të parapara për kontratën me titull: "Lot 10"Ndërtimi i Ndërtesës së IKAP-it" Prishtinë i datës 06.10.2020; Kërkesën për fillimin e procedurave te prokurimit për projektin "Ndërtimi i Objektit të IKAP" punët shtesë i datës 07.10.2020; Deklaratën e nevojave dhe Përcaktimit të Disponueshmërisë së fondeve sipas nenit 9 të ligjit të Prokurimit publik Nr.04/042 të datës; E-mailin e datës 13.09.2021 dërguar nga [] për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej dy faqesh; E-mailin e datës 10.11.2021 dërguar nga MSS Mobile Sanitary Srvicë për [] me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 16.11.2021 dërguar nga [] për [] me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; E-mailin e datës 16.11.2021 dërguar nga [] për [] E-mailin e datës 16.11.2021 dërguar nga [] për [] E-mailin e datës 03.02.2020 dërguar nga [] për Dekor-al; E-mailin e datës 20.04.2020 dërguar nga [] për Dekor-al; E-mailin e datës 20.04.2021 dërguar nga []

për Dekor-Al; E-mailin e datës 19.04.2021 dërguar nga Dekoral për ; E-mailin e datës 04.05.2020 dërguar nga për Dekor-al; E-mailin e datës 04.08.2020 dërguar nga për Dekor-Al; E-mailin e datës 07.08.2020 dërguar nga për Dekor-Al; E-mailin e datës 01.09.2020 dërguar nga për Dekor-Al me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 12.10.2020 dërguar nga për Dekor-Al; E-mailin e datës 20.04.2021 dërguar nga për Dekor-Al; E-mailin e datës 13.10.2020 dërguar nga për Dekor-Al; E-mailin e datës 20.10.2020 dërguar nga për Dekor-Al; E-mailin e datës 22.10.2020 dërguar nga për ; E-mailin e datës 19.11.2020 dërguar nga për Dekor-Al; E-mailin e datës 06.05.2021 dërguar nga për Dekor-Al; E-mailin e datës 31.08.2021 dërguar nga për me korrespondencën e bashkangjitur prej dy faqesh; E-mailin e datës 13.09.2021 dërguar nga ankuesi për Dekor-al me korrespondencën prej 3 faqesh; E-mailin e datës 09.08.2021 dërguar nga ankuesi për me korrespondencën prej 2 faqesh; E-mailin e datës 21.07.2021 dërguar nga ankuesi për NPSH Dekoral; E-mailin e datës 02.07.2021 dërguar nga ankuesi për NPSH Dekoral; E-mailin e datës 14.09.2021 dërguar nga për NPSH Dekoral; E-mailin e datës 14.09.2021 dërguar nga NPSH Dekoral për me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 14.09.2021 dërguar nga për NPSH Dekoral; E-mailin e datës 14.09.2021 dërguar nga për NPSH Dekoral; E-mailin e datës 09.09.2021 dërguar nga për NPSH Dekoral; E-mailin e datës 03.09.2021 dërguar nga për NPSH Dekoral; E-mailin e datës 15.04.2021 dërguar nga për NPSH Dekoral; E-mailin e datës 27.11.2020 dërguar nga për NPSH Dekoral me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; E-mailin e datës 30.10.2020 dërguar nga për NPSH Dekoral me korrespondencën e bashkangjitur prej 2 faqesh; E-mailin e datës 16.03.2021 dërguar nga për NPSH Dekoral dhe ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 4 faqesh; E-mailin e datës 01.04.2021 dërguar nga për ankuesin me korrespondencën e bashkangjitur prej 3 faqesh; Akt Emërimit dhe Vendimin ushtruesit të detyrës i Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit të ankuesit; Përshkrimin e detyrave të punës për pozitën e Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit; Vlerësimet e rezultateve në punë për ankuesin për vitin 2019 dhe 2020; Dëshmi me shkrim nëse ankuesi ka pasur me herët të shqiptuar ndonjë masë disiplinore; Dëshminë se kush ka qenë i ngarkuar me përgjegjësinë e Menaxherit të Projektit për realizimin e kontratës (komplet dosjen e kontratës) për të cilën ankuesi ngarkohet në pikën e I-rë të vendimit të Komisionit Disiplinor; Vendimin për themelimin e Komisionit Disiplinor të MPB - së; Kërkesën për iniciimin e Procedurës Disiplinore; Procesverbalet e seancës disiplinore të zhvilluar nga Komisioni Disiplinor; Ftesën për seancë publike të datës 21.02.2022 me numër prot:895/2022; Ftesën për seancë publike të datës 18.02.2022 me numër prot:860/2022; Ftesën për seancë publike të datës 18.2022 me numër prot:859/2022; E-mailin e datës 21.02.2022 me ftesën për seancë publike dërguar dëshmitarëve; E-mailin e datës 23.02.2022 me numër protokoll: 960/2022 me provat e bashkangjitura shtesë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit, me arsyetimin se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit ka bërë shkelje të dispozitave procedurale, konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, zbatim të

gabuar të ligjit material, shkelje të nenit 47 paragrafi 1, nën paragrafi 1.7 dhe nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative si dhe ka shkelur nenin 50 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas analizimit të shkresave të lëndës, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Punëve të Brendshme me rastin e nxjerrjes së Vendimit Nr.1424 të datës 17.12.2021 ankuesit i ka shqiptuar masën disiplinore "largim në Shërbimin Civil" me arsyetimin se e ka gjetur përgjegjës për shkeljet të rënda disiplinore të përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 nën paragrafi 3.1, 3.2, 3.3 dhe 3.10 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik të përcaktuara "Mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale dhe shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqë".

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave gjatë shqyrtimit të provave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë, ka Konstatuar se Komisioni Disiplinor me rastin e pranimit të kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit të datës 18.11.2021 nuk ka përmbushur detyrimet që i ka të përcaktuara me nenin 12 paragrafin 3 nën paragrafin 3.3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: "Seanca e Komisionit Disiplinor-Komisioni Disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit", ngase institucioni me rastin e dërgimit të provave të kërkuara nga ana e Këshillit, ka dërguar procesverbalin e seancës së mbajtur me datë 14.12.2021 si dhe evidentohet mungesa e ndërmarrjes së veprimeve siç i obligojnë dispozitat e lartcekura ngase nuk e ka ftuar në seancë edhe Zv/Sekretaren e Përgjithshme të Ministrisë së Punëve të Brendshme si iniciuese e kërkesës për fillimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit.

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit si dhe përgjegjësive dhe detyrave të tij të punës në kuadër të fushës së prokurimit, Kolegji ka analizuar dispozitat ligjore të Ligjit Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës neni 4 paragrafi 1 nën paragrafët 1.13 dhe 1.43 përcaktohet: "1.13-Autoriteti kontraktues - autoriteti publik, operatori i shërbimeve publike, ndërmarrja publike dhe/ose personi, komisioni, ose kompania private e cila operon në bazë të drejtave të veçanta apo ekskluzive, ose ndërmarrja që ushtron aktivitete të prokurimit në emër të/ose për llogari të autoritetit publik ose operatorit të shërbimeve publike ose një ndërmarrje publike; 1.43 Zyrtari i Prokurimit - personi i caktuar si drejtor të Departamentit të Prokurimit të autoritetit kontraktues sipas paragrafit 1 të nenit 23." neni 23 paragrafi 1 dhe nenin 24 paragrafi 1 i të njëjtit ligj përcakton se: "ZKA i autoritetit kontraktues përcakton një person të shërbej si Zyrtar Përgjegjës i Prokurimit për autoritetin kontraktues. Nëse punëtorët tjerë të autoritetit kontraktues janë nëpunës civil, Zyrtari i Prokurimit gjithashtu është nëpunës civil" dhe "Të gjitha aktivitetet e prokurimit janë përgjegjësi të autoritetit përkatës kontraktues pavarësisht nga shpërndarja e detyrave brenda autoritetit kontraktues sipas Nenit 22 të këtij ligji. Kjo nuk zbatohet në rastet kur Ministri i financave e ka caktuar AQP-në për kryerjen e një aktiviteti të caktuar të prokurimit sipas këtij ligji. Kurdo që AQP kryen aktivitetet e prokurimit në emër të autoritetit kontraktues, përgjegjësitë për këto aktivitete i merr përsipër AQP-ja", ka analizuar edhe Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik pika 61.4; 61.19; 61.20; 61.26 dhe 61.28 ku përcaktohet se: "6.14 Bartja e përgjegjësisë të Menaxheri i Projektit - Pasi të jetë nënshkruar kontrata nga të dy palët, Zyrtari përgjegjës i Prokurimit do ta informojë Zyrtarin Kryesor Administrativ "ZKA" dhe ZKA me shkrim do ta emërojë një Menaxher të Projektit përgjegjës për menaxhimin

(mbikëqyrjen) e kontratës specifike dhe për ta informuar Zyrtarin përgjegjës të Prokurimit; Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit 61.19 Menaxheri i Projektit do të: (a) Menaxhoj obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë; dhe (b) sigurojë se operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë. 61.20 Funkcionet e Menaxherit të Projektit janë: a) Të sigurojë që operatori ekonomik i përbush të gjitha obligimet e performancës apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik 149 b) Të sigurojë që operatori ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; c) të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përbush të gjitha pagesat dhe obligimet tjera në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; d) Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, cilësisë, dhe kohës aty ku është e përshatshme; e) Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës; f) Të sigurojë që të gjitha regjistrat e menaxhimit të kontratës të mbahen dhe arkivohen siç kërkohet; g) Të uxjerr variacione apo urdhra për ndryshim nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës; h) T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës Departamentit të Prokurimit dhe ta marr miratimin; i) Të menaxhojë dorëzimin e procedurave të pranimit; j) Te jep detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës Departamentit të Prokurimit; dhe k) T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit ose nga ZKA; 61.26 Kur menaxheri i projektit beson se duhet të ndërpritet një kontratë, menaxheri i projektit do të dorëzojë një rekomandim për ndërprerje tek departamenti i Prokurimit; 61.28 Asnjë kontratë nuk do të ndërpritet para marrjes së aprovimit nga Departamenti i Prokurimit dhe ZKA i autoritetit kontraktues. Kontrata ndërpritet kur Vendimi për ndërprerje i ZKA dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit bëhet i plotfuqishëm. Vendimi bëhet i plotfuqishëm kur nënshkruhet nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit" dhe po ashtu ka analizuar edhe përshkrimin e përgjegjësive dhe detyrave të punës për pozitën e Udhëheqësit të Divizionit Prokurimit dhe ka ardhur në përfundimin se i tërë aktiviteti i prokurimit në emër të një autoriteti kontraktues nuk lidhet në përgjegjësi të vetëm një individ apo nëpunësi civil mirëpo është përgjegjësi e autoritetit kontraktues referuar dispozitave në fuqi që rregullojnë fushën e prokurimit publik të cekura si më lartë.

Kolegji, në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se, kontrata me Operatorin Ekonomik për Ndërtimin e Objektivit të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM) është lidhur me datë 31.08.2018 ndërsa data e fillimit të punëve ka qenë 09.09.2018 me planin dinamik prej 36 muajsh, ndërsa sipas Raportit për projektin e Ndërtimit të Objektivit të KPM (Komisioni i Pavarur i Mediave) i dërguar nga menaxherja e projektit me datë 14.09.2021 pasqyrohet e gjithë kronologjia e rastit e ku për shkak të vonesave i ishte tërhequr vërejtja operatorit ekonomik me datë 03.02.2020 ndërsa për shkak të rrethanave të pandemisë me datë 04.05.2020 i kërkohet që i njëjti t'i rifillojë punimet sipas vendimeve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe po ashtu pas paralajmërimeve të datës 16.11.2020 si dhe datës 25.11.2020 për paralajmërimin e ndërprerjes së kontratës, Udhëheqësja e DMP/DSPIMNQ me datë 01.12.2020 e ka rekomanduar DP/MPB që të bëjë shkëputjen e kontratës, mirëpo pas tre takimeve të datës 16.03.2021, 19.03.2021 si dhe atij të datës 26.03.2021 ndërmjet U.D të Udhëheqësit të Divizionit të Prokurimit/MPB, Udhëheqësja e DMP/DSPIMNQ si dhe përfaqësuesit të Operatorit Ekonomik pas kërkesës së këtij të fundit i është mundësuar t'i ofrohet edhe një mundësi për ri-fillimin e punimeve, ndërsa pas kësaj datë, mirëpo sipas nenit 30.9 i RRUOPP-së thotë, AK para se të filloj procedurën e konfiskimit të sigurimit të ekzekutimit AK duhet të informoj, me shkrim, OE për çdo dështim të supozuar me kontratë dhe të jep OE kohë të mjaftueshme për korrigjim të dështimeve të tilla. Dështimi i OE për të korrigjuar, në kohë, dështime të tilla të supozuara do të rezultojë në procedurën e konfiskimit, natyrisht bazuar në këtë dhe në shkresat e lëndës AK duke zbatuar dispozitat e kontratës të lidhur në mes të AK dhe OE bazuar në nenin 42.2 - Zgjidhja Miqësore e Mosmarrëveshjeve të Kushtet e Veçanta të Kontratës-KVK ka provuar në mënyrë miqësore të

zgjidhen te gjitha çështjet ne mënyrë qe kontrata te realizohet dhe krejt ne fund pasi kane dështuar te gjitha përpjekjet e AK dhe menjëherë pas rekomandimit te menaxherit te kontratës pa asnjë vonese është realizuar shkëputja e kontratës), mirëpo pas kësaj kohe, për çdo vërejtje të menaxheres së projektit, ankuesi i ka përcjelle vërejtjen Operatorit Ekonomik deri në momentin kur me datë 14.09.2021 ka pranuar nga menaxherja e projektit raportin për ndërprerjen e kontratës me Operatorin Ekonomik, ndërsa ankuesi e ka marr parasysh dhe me datë 17.09.2021 e ka nxjerr vendimin për shkëputjen e kontratës me Operatorin Ekonomik, vendimi i cili është i nënshkruar edhe nga Sekretarja e Përgjithshme dhe është protokolluar me datë 20.09.2021 me numër:934, po ashtu me datë 17.09.2021 ankuesi e ka përgatit kërkesën për konfiskim të sigurimit të avancit e cila është protokolluar me datë 20.09.2021 me numër:935, si dhe me datë 14.10.2021 i është drejtuar Drejtorit të Departamentit Ligjor/MPB me kërkesën për iniciimin e procedurave gjyqësore-Padi ndaj Kompanisë PRISIG Sh.a për mos realizimin e konfiskimit të sigurimeve të Avancit me numër të polices seria/070150040007390 dhe Ekzekutimit me numër të polices seria/070150040007259, ndërsa Komisioni Disiplinor me datë 17.12.2021 ka nxjerr vendimin me Nr.1424/2021 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" me arsyetimin si në pikën 1. Mos penalizimi i Operatorëve Ekonomik, ankuesin e ka gjetur fajtor, sepse i njëjti nuk ka ndërmarrë masat e nevojshme për penalizimin e Operatorit Ekonomik me rastin e vonesave në Ndërtimin e Objektivit të Komisionit të Pavarur të Mediave (KPM), mirëpo në seancën e mbajtur Komisioni Disiplinor nuk ka ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme dhe nuk ka përmbushur obligimet ligjore që ka siç përcaktohet me nenin 12 paragrafin 3 nën paragrafin 1.2; 1.2 dhe 1.4 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: *"Merr në pyetje ose merr deklarata nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; Rishikon dokumentacionin përkatës; Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes"* dhe si pasojë nuk ka arritur ta konstatojë drejtë dhe saktë gjendjen faktike, ndërsa kërkesën e Sekretares së Përgjithshme të datës 18.11.2021 vetëm e ka shndërruar në masë disiplinore, ndërsa nuk i ka dhënë asnjë rëndësi shkresës-nyftimit me numër 32/2020 të KRPP-së të datës 10.09.2020 e cila në vete përmban mundësinë që Operatorëve Ekonomik dhe Autoriteteve Kontraktuese, për shkak të gjendjes së Pandemisë Covid-19 tu mundësohet zgjatja e periudhës së ekzekutimit të punëve, (edhe ashtu pa pasur nevojë ti vazhdohet afati i realizimit te punëve ne rastin konkret OE sepse kontrata ka pasur ende afat ligjor për periudhën edhe po te mos vazhdohej sipas shkresës nr. 32/2020 te KRPP-së, kontrata është lidhur ne mes palëve me date 05.09.2018 dhe sipas nenit 17.2 të *Kushtet e Veçanta të Kontratës-KVK* ka pasur afat 36 muaj pas nënshkrimit te kontratës) Pandemia Covid 19 konsiderohet si forcë madhore dhe ne rast se vjen deri te ndërprerja e kontratës si rezultat i forcës madhore, Sigurimi i Ekzekutimit nuk do te konfiskohet sipas kësaj shkrese te nxjerre nga KRPP-ja mbi bazën e kësaj ankuesi ne rastin konkret ka zbatuar te gjitha dispozitat ligjore te LPP dhe akteve tjera ligjore mbi prokurimin publik shih linkun <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/Documents/Notices/alb/429/20200910161150575.pdf>) dhe po ashtu Komisioni Disiplinor nuk ka arritur ta saktësojë se në cilin rast konkret përgjatë periudhës kohore menaxherja e projektit ka përgatitur raportin për ndërprerje e kontratës së punës me Operatorin Ekonomik dhe se i njëjti nuk është zbatuar ose marr parasysh nga ankuesi, ndërsa në arsyetim përdorë klauzola të përgjithshme të fajësisë. Po, ashtu vendimin e datës 07.09.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm për zbatimin e kontratës në fjalë ka qenë e caktuar si menaxhere e projektit Laureta Mulliqi, ndërsa ankuesi në seancën publike të mbajtur në Këshill me datë 22.02.2022 ka deklaruar se ndërprerja e kontratës është në kompetencë të Menaxherit të Prokurimit, mirëpo duhet përmbushur një parakusht siç përcaktohet me pikën 61.26 te Rregullat dhe Udhëzuesin Operativ për Prokurimin Publik të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik ku përcaktohet se: *"Kur menaxheri i projektit beson se duhet të ndërpritet një kontratë, menaxheri i projektit do të dorëzojë një rekomandim për ndërprerje tek departamenti i Prokurimit"* dhe se ky obligim është përmbushur me rastin e kërkesës-raportit për ndërprerjen e

kontratës nga ana e menaxherit të projektit me datë 14.09.2021, ndërsa ankuesi e ka marr parasysh dhe me datë 17.09.2021 e ka nxjerr vendimin për shkëputjen e kontratës me Operatorin Ekonomik, vendimi i cili është nënshkruar edhe nga Sekretarja e Përgjithshme dhe është protokolluar me datë 20.09.2021 dhe numër prot:934 si dhe ka vazhduar me ndërmarrjen e veprimeve të tjera procedurale ligjore të përcaktuara si më lartë, andaj mbi këtë bazë Kolegji ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara ndërsa Komisioni Disiplinor ndërlidhur me nenin 12 paragrafi 5 Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: *‘Vendimi në komision disiplinor merret siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative’*, ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3; 1.4; 1.5 dhe 1.6 ku përcaktohet: *“Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim”* si dhe në kundërshtim me nenin 88 paragrafi 1 dhe 2, nenin 90 paragrafi 2 i të njëjtit ligj ku përcaktohet: *“1. Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore. 2. Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen; 2. Sigurimi i provave mund të bëhet në cilëndo fazë të procedurës, qoftë edhe para fillimit të saj. Përgjegjësia për të siguruar provat bie në kompetencën e organit publik që udhëheq procedurën administrative”*, ngase Komisioni Disiplinor nuk ka ndërmarr asnjë hap të vetëm për të vërtetuar saktë gjendjen faktike siç obligohet me ligj, nuk ka ftuar asnjë dëshmitar në seancë, nuk ka rishikuar dokumentacionin e çështjes, nuk ka marr asnjë informatë zyrtare për shkresën e datës 10.09.2020 me numër 32/2020 nga ana e Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP-së), dhe nuk ka ftuar në seancë as menaxheren e projektit.

Po ashtu, Kolegji në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se Komisioni Disiplinor me datë 17.12.2021 ka nxjerr vendimin me Nr.1424/2021 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore *“Largim nga Shërbimi Civil”* dhe me arsyetimin si në pikën 2. Parregullsi në procedurat e negociuara pa publikim të njoftimit të kontratës, ankuesin e ka gjetur fajtor me arsyetimin se i njëjti, *citohet: “z. edhe pse ka qenë në dijeni së njësisë kërkuese nuk ka bazë ligjore të krijon komisione për vlerësim dhe negociim të punëve shtesë, nuk ka reaguar në mos pranim të atyre komisioneve meqenëse kanë qenë në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 9.1, neni 40 paragrafi 40.1 dhe 61 paragrafi 61.24 të Rregullit dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik”* me rastin e negociimit të punëve shtesë ngase komisioni vlerësues ka qenë i jashtëligjshëm. Kolegji ka analizuar nenet-pikat e Rregullit dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik të cituara si më lartë dhe ka ardhur në përfundim se përmbajtje e tyre me konstatimet e Komisionit Disiplinor kanë shpërpushej të plotë, ndërsa në seancën publike e mbajtur me datë 22.02.2022 Këshilli i ka ftuar në cilësinë e dëshmitarëve anëtarët e këtij komisioni i cili është cilësuar si i jashtë ligjshëm nga ana e Komisionit Disiplinor dhe z.

ndërsa në pyetjen e Kryetarit të Kolegji: Ndërlidhur me piken e dytë (*Parregullsi në Procedurat e Negociuara pa Publikim të Njoftimit të Kontratës, lutje referuar si pika 2*) që ministria-Komisioni Disiplinor të ka shpallur fajtor, e pyet ankuesin dhe dëshmitarët e pranishëm, a mund ta sqaroni si aprovohen kërkesat për punës shtese, para se me fillua negociimin. A e ke pas aprovimin e ZKF dhe ZKA, a ke pas njoftim qe janë aprovua paraprakisht, ndërsa dëshmitarja e merr fjalën ndërsa dëshmitarët e tjerë pajtohen të fletë në emër të tyre, citohet: *Lidhur me punët shtesë për ndërtesën e IKAP, sa i përket kësaj temë qe 20 vite është kjo mënyre e procedimit, OE bënë kërkesën për punë shtesë fillimisht, punën shtesë e aprovon menaxheri i kontratës dhe e arsyeton se kjo punë duhet me u krye,*

pastaj menaxheri i kontratës kërkon prej drejtorit të DSIPMNQ të krijojë një komision profesional nga të gjitha fazat, mandej drejtori i DSIPMNQ krijon komisionin nga ekspertët e fushës gjatë duke ja bërë CC udhëheqësit të zyrës së prokurimit, komisioni në fjalë e njofton operatorin ekonomik dhe dillet në teren së bashku me menaxheren e kontratës, në teren evidentohen te gjitha pozicionit dhe maten sasitë. Prej përvojës kemi te evidentuarn pozicione shtese por të cilat figurojnë në bazë të kontratës bazë dhe kanë çmime, por ka raste kur kemi pozicione shtese jashtë kontratës baze, d.m.th këto pozicione dhe ky komision i eksperteve për punët shtese e të cilat ekzistojnë në kuadër të kontratës bazë, çmimet mbesin te njëjta, ndërsa për pozicionet të cilat nuk ekzistojnë në kuadër të kontratës bazë hulumtohen çmimet e tregut. Andaj ne si komision kemi qenë te emëruar me një e-mail zyrtarë- dhe kemi kryer anën profesionale ashtu si na takon. Raportin të cilin ne si komision e kemi bërë në bazë të vendit të ngjarjes, dokumentacionin të cilin e kemi poseduar ne e kemi dërguar me raport lidhur me vlerësimin e punëve shtese përmes Udhëheqëses së divizionit DPPD, Drejtorit të DSIPMNQ, Sekretarit të përgjithshëm të MPB të Udhëheqësi i ZP” po ashtu edhe ankuesi është përgjigjur në pyetjen e parashtrua se, citoj: “(Rreth punëve shtese për objektin IKAP) përgjegjësinë ligjore e ka divizioni i prokurimit, zyrtari përgjegjës i prokurimit mirëpo vetëm pasi te pranohet dokumentacionin e komisionit për iniciim të procedurës së prokurimit dhe disponueshmërisë së mjeteve të cilat janë të aprovuara nga njësia kërkuese, ZKA dhe ZKF. Prej këtij momenti përgjegjësia kalon në divizionin e prokurimit, raporti i komisionit të cilit i referohet Komisioni Disiplinor është i aprovuar dhe nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit, menaxheri i projektit, shefi i divizionit, drejtori i departamentit të DSIPMNQ dhe ZKA. Divizioni i prokurimit i ka ndjekur në obligimet ligjore në harmoni me ligjin për prokurim publik dhe RRUOPP duke filluar prej njoftimit për KRPP, dhe është dërguar dosja dhe kjo është procedurë e rregullt” ndërsa në pyetjen e Anëtarit i Kolegjit z. “Gjatë cilës kohë ke qenë ushtrues i detyrës së udhëheqësit të prokurimit, a ka pasur vërejtje nga Njësia e Auditimit rreth mënyrës së caktimit të këtyre komisioneve të cilin Komisioni Disiplinor e ka quajtur të jashtëligjshëm”, ankuesi është përgjigjur: “Jo nuk kemi pasur asnjëherë asnjë vërejtje as nga KRPP dhe as nga Njësia e Auditimit madje janë marrë si praktika të mira rastet e tilla”, dhe po ashtu Kolegji në bazë të shkresave të lëndës ka ardhur në përfundim se në bazë të shkresës së datës 08.10.2020 se raporti i Komisionit Vlerësues të cilin Komisioni Disiplinor e ka quajtur të jashtëligjshëm pasi që nuk është themeluar nga ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ) në fakt është i nënshkruar nga vetë ZKA (Zyrtari Kryesor Administrativ)-Sekretari i Përgjithshëm i ministrisë nga Drejtori i DMP/DSPIMNQ dhe nga DPPS/ DSPIMNQ. Sipas RRUOPP-së, Ndryshimi i kontratës sqarohet me nenin 61.22 Ndryshimi i kontratës i referohet një ndryshimi në termat dhe kushtet e një kontrate të shpërblyer. Ndryshimi i kontratës iniciohet nga Menaxheri i kontratës (sqarim lidhur me punët shtese sepse ne rastin konkret sipas LPP-së është përmbushur kushti për aprovimin e punëve shtese me aprovimin e menaxherit te kontratës sepse ne fund te fundit ky veprim i DSIPMNQ është i një departamenti tjetër dhe i cili para se te aprovohet puna shtese është i obliguar te përcaktoj vlerën paralogaritur për të iniciuar AP ne rastin e cekur me larte për pozicionet e punëve shtese te cilat janë ne kontratën baze përdoren çmimet e kontratës baze ndërsa për pozicionet e reja te cilat nuk kane çmime menaxheri i kontratës ne bashkëpunim me stafin profesional te DSIPMNQ kane hulumtuar tregun qe te përcaktojnë vlerën e atyre pozicioneve ne mënyrë qe te procedojnë me kërkesën për iniciim sepse para se te iniciohet një AP duhet te përcaktohet vlera paralogariture për pune shtese meqë nuk lejohet te ndryshohet apo shtohet kontrata me shumë se 10 % te vlerës totale te kontratës baze andaj nëse nuk dihet vlera paralogariture nuk mund te fillohet procedura për pune shtese dhe kjo është arsyeja qe ata kane krijuar një komision për te verifikuar dhe siguruar vlerën paralogariture dhe konstatohet se ankuesi ka respektuar ne tërësi te gjitha dispozitat ligjore te LPP-së dhe mbi këtë bazë Kolegji konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit për këtë pikë është i bazuar ndërsa Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinor iu është referuar gabimisht dispozitave ligjore të fushës së prokurimit dhe nuk është provuar me fakte apo konstatuar nga ekspertë të fushës dhe si rrjedhojë ka vepruar në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 Ligjit Nr.05/L-031 për

Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme"*, sepse Kolegji ka konstatuar se me veprimet e tyre (të komisionit që Komisioni Disiplinor e konsideron të jashtëligjshëm) nuk është shkaktuar asnjë dëm i cili do të mundë të argumentohet. Për më tepër Komisioni Disiplinor i lejon vetës që të konstatoj se raporti i Komisionit të lartpërmendur ka vë në lajthitje Komisionin që ka caktuar ZKA, ndërsa në shkresat e lëndës nuk gjendet asnjë dëshmi që të këtë marr në pyetje në cilësinë e dëshmitareve Komisionin e themeluar në ZKA dhe të dëgjoj se a janë vëre në lajthitje. Prandaj Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor ka zbatuar procedurën disiplinore duke krijuar hipoteza në bazë të cilave ka shqiptuar masën disiplinore nga shërbimi civil për ankuesin, duke i falë besimin vetëm shkresës inicuese për procedim disiplinor. Por në tersi me qëllim ose pa qëllim ka fshehur dhe nuk ka administruar asnjë shkresë që shkon në favor të ankuesit, prandaj Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor nuk ka arritur të trajtoj lëndën në mënyrë objektive dhe të drejtë.

Kolegji, në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se Komisioni Disiplinor me datë 17.12.2021 ka nxjerr vendimin me Nr.1424/2021 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" dhe me arsyetimin si në pikën 3. Parregullsi në procedurën e prokurimit "Mirëmbajtje dhe Përkrahje e Sistemit e-pasuria", me arsyetimin se i njëjti sipas sugjerimit të Drejtorit të Agjencisë së Shoqërisë së Informacionit se grupi punues specifikave të tenderit të tenderit në ASHI ka konstatuar se termat e referencës tek pjesa "kërkesat teknike dhe profesionale janë ndryshuar dhe publikuar ndryshe", ndërsa Kolegji ka gjetur se ankuesi me datë 15.07.2021 i ka kthyer sqarime përmes e-mailit zyrtar Drejtorit të ASHI-së, se: *"ajo që e ka potencuar grupi punues i specifikave të tenderit qëndron, mirëpo me sqarimin se Specifikat e teknike dhe termat e referencës të dërguara nga ana e njësisë së kërkesës ASHI nuk janë prekur ngase janë përgjegjësi e saj, mirëpo kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale dhe përpilimi i dosjes së tenderit janë përgjegjësi e Divizionit të prokurimit dhe nuk është kompetencë as e komisionit për hartim të specifikave dhe as e njësisë së kërkesës në rastin konkret ASHI-së, dhe po ashtu kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale janë vendosur nga divizioni i prokurimit në harmoni të plotë me natyrën e prokurimit dhe mandatit ligjor të DP-së referuar më herët edhe nenit 11 dhe 69 të Ligjit për Prokurimin Publik"*, po ashtu në seancën e mbajtur në Këshill me datë 22.02.2022 ishte ftuar në cilësi të dëshmitarit edhe në cilësinë e Drejtorit të ASHI-së me datë 21.02.2022 përmes e-mailit me ftesën e protokolluar me numër:895/2022, mirëpo i njëjti nuk e kishte konfirmuar pjesëmarrjen dhe as paraqitjen me kohë, ndërsa i njëjti ishte lajmëruar në ditën e mbajtjes së seancës përmes e-maili dhe telefoni, mirëpo pjesa e pikës 3 për të cilën ishte e nevojshme të dëshmojë ishte konsumuar dhe mbaruar, ndërsa ankuesi në pyetjen e Kryetarit të Kolegjit se: *"Si qëndron e vërteta sipas teje lidhur me shkëlqen në pikën 3 të evidentuar nga Komisioni Disiplinor se ASHI ka vërejtur se specifikat e tenderit janë ndryshuar nga ana e divizionit të prokurimit gjegjësisht nga grupi punues i specifikave të tenderit dhe ASHI ka konstatuar se te termat e referencës tek pjesa kërkesa teknike dhe profesionale janë ndryshuar dhe publikuar të ndryshëm"*, ankuesi ishte përgjigjur se: *"Konstatoj edhe njëherë se specifikat teknik të dërguara nga njësia kërkuese nuk janë prekur asnjë presje, duhet të kenë parasysh se po flasim për çështje të ndryshme, diametralisht të ndryshme, ligjërisht të përcaktuara në nenin 18.7 i RRUOPP citoj "Zyrtari i Prokurimit është përgjegjës për përgatitjen e dosjes së tenderit. Ai është plotësisht përgjegjës për përgatitjen e dokumenteve të tenderit, kritereve të përzgjedhjes, si dhe kritereve të dhënies, ndërsa specifikimet teknike do të përgatiten nga struktura të specializuara në çështjen që do të prokurohet, brenda AK" si dhe në paragrafin 1 të nenit 69 citat "Autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik të sigurojnë dëshmi për të treguar se ata i posedojnë kualifikimet minimale të kërkuara dhe specifikuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin e kontratës. Gjatë vendosjes së kësaj kërkesë, autoriteti kontraktues mund të kërkojë nga operatorët ekonomik që të sigurojnë, nëse është relevante dhe e nevojshme, njërin ose të gjitha dokumentet e specifikuara në këtë nen, 4.1 i nenit 69 i LPP citat "kualifikimet shkollore dhe profesionale të personelit udhëheqës të operatorit ekonomik dhe, në veçanti, të*

personit ose personave që drejtpërdrejt është ose janë përgjegjës për sigurimin e shërbimeve”, si dhe pyetja 86 në KRPP tek pyetje e shpeshita, citat “ Në kuptim të dispozitave të lartë cituara, kurdo që Autoriteti Kontraktues ushtron aktivitetin e prokurimit për të dhënë një kontratë të veçantë, dy apo më shumë Operator Ekonomik pjesëmarrës në aktivitetin e prokurimit MUND të mbështeten në kapacitetet financiare, teknike dhe/ose profesionale të të njëjtit Operator Ekonomik (marrëveshje për mbështetje financiare, marrëveshje për shfrytëzimin të pajisjeve apo marrëveshje me të njëjtin inxhinier), ngase në këtë rast vetëm një Operator Ekonomik që plotëson kriteret e përzgjedhjes dhe të dhënies, ka për të fituar kontratën”, ... si dhe në paragrafin 4.1 i nenin 69 i LPP të citohet, si dhe pyetja 86 në KRPP tek pyetje e shpeshita”, ndërsa në pyetjen e dytë të Kryetari i Kolegjit, se: “Pse është anuluar tenderi në fjalë dhe në cilën kohë”, ankuesi është deklaruar se: “Pas hapjes së ofertave me kërkesë të ZKA mbështetur në Raportin e Auditimit është kërkuar nga divizioni i prokurimit që ky tender të Anulohej”, andaj me këtë rast Kolegji ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor edhe për këtë pikë është dashur ta ftojë në seancë iniciuesin e kërkesës për fillimin e procedurës disiplinore, Drejtorin e ASHI-së në cilësi të dëshmitarit si dhe të shqyrtojë dhe analizojë saktë bazën ligjore se ku qëndron e vërteta në këtë mes duke mos anashkaluar asnjëherë obligimet ligjore që ka, njëherit veprim ky i ushtruar në kundërshtim me Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3; 1.4; 1.5 dhe 1.6 ku përcaktohet: “Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeve pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim”.

Po ashtu, Kolegji në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se Komisioni Disiplinor me datë 17.12.2021 ka nxjerr vendimin me Nr.1424/2021 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore “Largim nga Shërbimi Civil” dhe me arsyetimin si në pikën 4. Vonesa e inicimit të procedurave të prokurimit dhe vendosja në lajthitje e mbikëqyrësit, me arsyetimin se kërkesat e bërë nga Departamenti për Standarde dhe Politika të Inxhinieringut dhe menaxhimit të Ndërtesave Qeveritare (DSPIMNQ) për punë shtesë për projektet: Ndërtimi i objektit të QTM-Pejë faza 1me datë 21.08.2020, Ndërtimi i ndërtesës së IKAP-it me datë 09.03.2022 dhe ndërtimi i Qendrës për Vlerësim dhe Standarde QVS me datën 12.03.2021, të cilat janë aprovuar nga ana e ish Sekretarit të Përgjithshëm por nuk janë proceduar tutje, ndërsa në seancën e datës 22.02.2022 ankuesi është deklaruar se: “Vonesat nuk kanë qëndruar në divizionin e prokurimit pas aprovimit të këtyre. Kërkesa fillimisht është kërkuara gojarisht të mos procedohet ndërsa me datë 23.03.2021 është kërkuar zyrtarisht përmes e-mailit nga zyra e Sekretarit me kërkesën citoj: “është kërkuar nga ZKA të pezullohet të gjitha aktivitetit e prokurimit” e cila iu është konfirmuar nga ana ime më të njëjtën datë se nuk do të fillojnë asnjë procedurë të re të prokurimit përveç atyre që janë në procedurë e sipër. Kur është vendos me filluar me procedura të prokurimit për projektet në fjalë me datën 07.05.2021 është nxjerre njoftimi të cilin e krijon sistemi i E-prokurimit dhe i cili është i nënshkruar nga ana ime me datë 07.05.2021 dhe është dërguar në zyre të ZKA dhe nuk është nënshkruar nga ai. Me datën 13.07.2021 pasi u ndërruar ZKA-ja e kam ri-iniciuar procedurën për (IKAP dhe QVS) dhe ju kam drejtuar për aprovim, ndërsa ZKA e ka aprovuar me datë 19.10.2021 pas më shumë se 3 muajsh dhe kjo nuk mund të jetë vonesë e imja” dhe këtë deklaram ankuesi e ka mbështetur edhe me prova dhe fakte veç e veç me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill me datë 14.01.2022 (lidhur me kërkesën për ri-inicim nga njësia kërkuese nuk është përgjegjësi e ankuesit dhe në rastin konkret është dashtë që njësia e kërkesës dhe ZKA të sqarohen lidhur me këtë situatë e jo të ngarkohet me përgjegjësi ankuesi të cilat nuk i takojnë sepse dihet që menaxheri i prokurimit nuk ka të drejtë të inicioj apo të ri-inicioj procedura por vetëm të zbatoj dhe zhvilloj procedurat sipas kërkesave dhe nevojave të AK) të cilat Kolegji i ka administruar, andaj me këtë rast pretendimi i ankuesit është i bazuar ngase nuk është përgjegjës për vonesën e procedimit të kërkesave të aprovuara tutje pasi që i njëjti ka zbatuar kërkesën e ish Sekretarit të përgjithshëm njëherit udhëheqës i tij i drejtpërdrejtë, ndërsa Komisioni Disiplinor

pavarësisht deklarimeve të ankuesit edhe në seancën e mbajtur të Komisionit Disiplinor i ka potencuar mirëpo të njëjtat nuk janë vlerësuar si prova me rëndësi, dhe me këtë rast ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative neni 48 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3; 1.4 dhe 1.5 ku përcaktohet: *"Shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të proovave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsytet pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve"*.

Kolegji në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se Komisioni Disiplinor me datë 17.12.2021 ka nxjerr vendimin me Nr.1424/2021 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore "Largim nga Shërbimi Civil" dhe me arsyetimin si në pikën 5. Neglizhencat në kryerjen e detyrave në lidhje me adresimin e problemit rreth mirëmbajtjes higjienike objektit të Rilindjes, me arsyetimin se ankuesi nuk kishte vepruar sipas kërkesës së Sekretarit të Përgjithshme lidhur me kërkesën për shqetësimin e ngritur për mungesë të materialeve higjienike dhe se i është kërkuar të bëjë mbulimin e shërbimeve të mirëmbajtjes përmes kontratës kornizë, ndërsa deklarin e ankuesit se i njëjti nuk ishte përgjegjës porse për një gjë të tillë Komisioni Disiplinor nuk e ka marr për bazë me theksin se po mos të kishte qenë përgjegjës nuk kishte vepruar as pas kërkesës së përsëritur të Sekretarit të Përgjithshëm duke iu referuar obligimeve ligjore që ka ankuesi sipas pikës 56.1 të Rregullit dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik, ndërsa Kolegji ka analizuar se çfarë përmban norma të cilës ju ka referuar respektivisht pika 56.1 të Rregullit dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik ku përcaktohet se: *"56.1 "Kontratë publike kornizë" nënkupton një marrëveshje për një periudhë të kufizuar në mes të një apo me shume autoriteteve kontraktuese si dhe një apo më shumë operatorëve ekonomik, qëllimi i të cilës është vendosja e termave që udhëheqin kontratat që duhen dhënë gjatë një periudhë të caktuar, posaçërisht në lidhje me çmimin si dhe, kurdo që është e përshtatshme edhe sasinë e theksuar"* dhe mbi këtë bazë Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor e ka gjetur përgjegjës ankuesin mbi bazën e një norme e cila në vete nuk asnjë pikë ku ankuesin e bënë përgjegjës dhe po ashtu ankuesi edhe mund ta ketë zbatuar kërkesën e përsëritur Sekretarin Përgjegjës për faktin se ka qenë udhëheqës i tij i drejtpërdrejtë dhe se i njëjti e ka zbatuar një urdhër, mirëpo Komisioni Disiplinor në secilin rast është dashur ta ketë pasur parasysh Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës neni 24 paragrafi 1 i të njëjtit ligj përcakton se: *"Të gjitha aktivitetet e prokurimit janë përgjegjësi të autoritetit përkatës kontraktues pavarësisht nga shpërndarja e detyrave brenda autoritetit kontraktues sipas Nenit 22 të këtij ligji. Kjo nuk zbatohet në rastet kur Ministri i financave e ka caktuar AQP-në për kryerjen e një aktiviteti të caktuar të prokurimit sipas këtij ligji. Kurdo që AQP kryen aktivitetet e prokurimit në emër të autoritetit kontraktues, përgjegjësitë për këto aktivitete i merr përsipër AQP-ja"* dhe lehte ka mundur ta vërtetoj faktin nëse vërtet është përgjegjës njësia kërkuuese (DSPIMNQ), sepse dihet fare mire me LPP për menaxhimin e kontratës është përgjegjës menaxheri i projektit i caktuar me vendim të ZKA dhe njësia kërkuuese bazuar në shkresat e lëndës ka vepruar duke kërkuar nga OE të ofroj shërbimet dhe është konfirmuar nga OE ku menjëherë kanë filluar të ofrojnë shërbimet e kërkuara sipas deklarimeve të ankuesit dhe shkresave të lëndës, sipas deklarimeve të ankuesit, andaj mbi këtë bazë pretendimi i ankuesit është i bazuar.

Kolegji, në bazë të shkresave të lëndës të kërkuara nga institucioni punëdhënës ka gjetur se, ankuesi për vitin 2019 për rezultatin në punë sipas formularit të vlerësimeve në punë për vitin 2019 i datës 31.12.2019 është vlerësuar me notën e përgjithshme (4.8 apo shkëlqyeshëm) ku sipas dispozitave ligjore në fuqi për Shërbimin Civil nota shkëlqyeshëm është nota më e lartë-pozitive, ndërsa për vitin 2020 sipas formularit të vlerësimit e rezultateve në punë për vitin i datës 01.02.2021 është vlerësuar me notë të përgjithshme (4.12 apo shumë mirë), ndërsa sipas e-mailit të datës 23.02.2022 dërguar nga Menaxherja e Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, është konfirmuar se ankuesi nuk ka

asnjë masë të shqiptuar disiplinore në 5 (pesë) vitet e fundit dhe as nuk ka ndonjë masë aktive aktuale, dhe mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se ankuesi gjatë kryerjes së detyrave dhe përgjegjësive të tij të punës në bazë të këtyre provave është sjellë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik neni 28 ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij"*.

Kolegji, gjatë shqyrtimit dhe peshimit të gjitha provave veç e veç si dhe të gjitha së bashku si tersi, ka konstatuar se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës më të rëndë disiplinore në Shërbimin Civil-Largim nga Shërbimi Civil nuk ka marrë për bazë dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik neni 50 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ku përcaktohet se: *"Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në: Ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji"*, ngase në bazë të gjeturave si më lartë ankuesi nuk ka pasur asnjë masë të shqiptuar disiplinore si dhe vlerësimet e rezultateve të punës i ka pasur shume të mira respektivisht të shkëlqyeshme në vitet e fundit, andaj si fakte të pamohueshme Komisioni Disiplinor është dashur t'i ketë parasysh jo vetëm me rastin e shqiptimit të masës disiplinore, por qysh në filllet e hapjes së procedurës disiplinore dhe se të tilla fakte nuk mund të anashkalohen.

Po ashtu Komisioni Disiplinor me rastin e shqyrtimit të kërkesë për iniciimin e procedurës disiplinore respektivisht nxjerrjen e vendimit të datës 17.012.2021 me numër:1424 me të cilin ankuesit ia ka ndërprerë marrëdhënien e punës, nuk ka përmbushur obligimet ligjore dhe procedurale administrative të përcaktuara në Ligjin për procedurën e Përgjithshme Administrative të përcaktuara si më lartë në disa pjesë të arsyetimit të këtij vendimi si dhe ato të përcaktuara qartë në nenin 12 paragrafin 3 nën paragrafin 3.1; 3.2; 3.3 dhe 3.4 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: *"Merr në pyetje ose merr deklarata nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit; Rishikon dokumentacionin përkatës; Kryen çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e ngjarjes"* dhe me këtë rast ka shkëlqur nën 7 paragraf 1 të ku përcaktohet se: *"Menaxhimi i marrëdhënies juridike me nëpunësit civilë, me nëpunësit e Shërbimit Publik dhe me nëpunësit administrativo-teknikë dhe mbështetës, udhëhiqet nga ligji dhe bazohet, gjithashtu, në parimin e mundësive të barabarta, meritës, transparencës, profesionalizmit dhe pammësisë politike, mos diskriminimit, përfaqësimit të drejtë gjinor dhe të komuniteteve dhe synon garantimin e qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë në detyrë"*, pasi që gjatë zhvillimit të procedurës së shqiptimit të masës disiplinore ndërldhur edhe me nenin 12 paragrafi 5 Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet se: *"Vendimi në komision disiplinor merret siç përcaktohet në dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative"*, Komisioni Disiplinor ka arritur në përfundim vetëm mbi bazën e kërkesës për iniciimin e procedurës disiplinore nga Sekretarja e Përgjithshme, duke anashkaluar apo vepruar në atë mënyrë që të merr në pyetje ose merr deklarata nga dëshmitarët dhe verifikon faktet; të fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit; të rishikojnë dokumentacionin përkatës; të kryej edhe çdo veprim tjetër të nevojshëm për verifikimin e saktë të ngjarjes.

Po ashtu, në bazë të procesverbalit të seancës se datës 14.12.2021 së organizuar nga Komisioni Disiplinor, Kolegji ka gjetur se ankuesi nuk ka qenë i njoftuar me të gjeturat e Raportit të Njesisë së Brendshme të Auditimit mbi bazën e të cilit i ishte iniciuar procedura disiplinore, ndërsa në përgjigjen e ankuesit në seancë i njëjti e ka quajtur të paligjshme mos njoftimin e tij më këtë raport si dhe pamundësinë për të kundërshtuar të gjeturat, ndërsa Komisioni Disiplinor nuk ka ndërmarr asnjë

veprim dhe as institucioni punëdhënës me rastin e dërgimit të provave nuk ka arritur ta dëshmojë në gjë të tillë nëse ankuesi është i njoftuar me Raportit të Njesisë së Brendshme të Auditimit, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor ka vepruar në kundërshtim me nenin 9 paragrafi 2 dhe nenin 90 paragrafi 1 dhe nenin të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Organi publik duhet të garantojë të drejtën e palës për t'u informuar mbi ecurinë e procedurës administrative, qasjen në dosjen dhe dokumentet e tij dhe të drejtën e njoftimit me mjete të përshtatshme, në pajtim me këtë Ligj; Nëse marrja e një prove të nevojshme, mund të bëhet e pamundur ose e vështirë, organi publik, sipas detyrës zyrtare apo sipas kërkesës së arsyetuar të palës, mund të vendosë për sigurimin e provës"*, njëherit kanë vepruar në kundërshtim edhe me nenin 11 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *"Organi publik, gjatë procedurës administrative, ndihmon që palët të mbrojnë dhe realizojnë të drejtat dhe interesat e tyre juridike, sa më lehtë të jetë e mundur por pa cenuar të drejtat dhe interesat juridik të personave të tjerë"* dhe në kundërshtim edhe me nenin 43 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Nëpunësit civilë kanë të drejtë në trajtim të barabartë në të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit, duke përfshirë karrierën, shpërblymjet, kompensimin dhe mbrojtjen ligjore, pavarësisht nga gjinia, raca, besimi fetar, politik, aftësitë e kufizuara, kushtet, statusi martesor, mosha ose prejardhja etnike"*, pasi që ankuesi qysh në fillim të inicimit të procedurës disiplinore ka qenë i penalizuar me rastin e mos njohjes së rrethanave dhe të gjeturave të Raportit të Njesisë së Auditorit të Brendshëm, ndërsa ky fakt ka qenë jetik në aspektin e përgatitjes së mbrojtjes dhe sigurimit të provave nga ana e tij.

Po ashtu, është për tu theksuar fakti sikurse u potencua edhe më lartë në arsyetim të këtij vendimi se Komisioni Disiplinor nuk ka ndërmarr të gjithë hapat procedural e ligjor për të bashkëvepruar me të gjithë mekanizmat brenda institucionit e cila dëshmohet edhe me rastin e nxjerrjes së vendimit të Komisionit Disiplinor të datës 17.12.2021, ku në pikën 1 të dispozitivit ankuesit i referohet me ish UD i Udhëheqësit të Prokurimit, ndërsa ankuesi me datë 18.11.2022 me vendim të Sekretares së Përgjithshme ishte liruar nga pozita e UD i Udhëheqësit të Prokurimit, dhe i njëjti sipas ndryshimit dhe plotësimit të akt emërimit të datës 06.04.2016 me Nr.28/2016 në kohën e shqiptimit të masës disiplinore e mbante pozitën e Zyrtarit të Lartë të Prokurimit.

Andaj, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas administrimit të provave të ofruara nga palët në procedurë si dhe në bazë të gjeturave me shkeljet e evidentuara e të theksuara si më lartë në këtë vendim, ka konstatuar se vendimi me numër:1424/2021 i datës 17.12.2021 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Punëve të Brendshme është i kundërligjshëm siç përcaktohet edhe me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative nenin 52 paragrafi 1 nën paragrafët 1.3, 1.4, 1.5, 1.6 dhe 1.7 ku përcaktohet: *"Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.4. është nxjerre në kundërshtim me dispozitat që rregullojnë formën apo elementet e detyrueshme të aktit administrativ; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme, apo 1.7. nuk është në pajtim me parimin e proporcionalitetit"* dhe si i tillë është shfuqizuar me të gjitha veprimet dhe efektet e tjera juridike që rrjedhin prej tij.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.29/2022

Flakron GASHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme ;
- Menaxherit të Personelit të Ministrisë së Punëve të Brendshme
- Arkivit të KPMSHCK-së

